

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Von der Leyen anashkalon Serbinë dhe Bosnjën në turneun e saj në Ballkan
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/von-der-leyen-anashkalon-serbine-dhe-bosnjen-ne-turneun-e-saj-ne-ballkan-i586888
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 13:10:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6df84bbc4b0c9eb7889b6f09d6f45bd103c1a1f82e5dd473592b565366828ce8
TEKSTI	c8e3f9405e73fec5375063091492ac85ecbfa25d5e56f7120fdc57be3ff8c569
PAMJA	5d786ffa1d072acc863a433c062c1eff0c8292e8b01816eef7c1f4101fb2e281

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	125d4585e59eb2e27d4da593d2bd6c35b62e25021d72c23dfe2fdad005bab85a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9c628a07075feceb8104ab280f983adfb76a5f01a86c5eb5ef058772798de17b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/125d4585e59eb2e27d4da593d2bd6c35b62e25021d72c23dfe2fdad005bab85a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



18 Shtator 2026, 15:10Rajoni TEMA
fundi

Von der Leyen anashkalon Serbinë dhe Bosnjën në turneun e saj në Ballkan



18 Shtator 2026, 15:10Rajoni TEMA



Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do t'i anashkalojë Serbinë dhe Bosnjë e Hercegovinën gjatë turneut të saj në Ballkan, njoftoi të premten Komisioni Evropian.

"Gjatë turneut, presidentja von der Leyen do të vizitojë Tiranën, Prishtinën, Podgoricën dhe Shkupin. Atje do të takohet me presidentët dhe kryeministrat, si dhe do të vizitojë projekte të financuara nga Bashkimi Evropian", tha zëdhënësjja e Komisionit Evropian, Arianna Podesta.

Vizita në katër vendet e rajonit është paraparë të zhvillohet nga 30 shtatori deri më 2 tetor.

Radio Evropa e Lirë kishte raportuar më herët për mundësinë që von der Leyen, nëse nuk do ta vizitonte Serbinë, të mos shkonte as në Bosnjë e Hercegovinë.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, prej vitesh ka pasur një raport të ngrohtë me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, të cilit shpesh i është drejtuar me fjalët "i dashur Aleksandar". Kjo qasje është kritikuar nga ekspertë që merren me Ballkanin Perëndimor.

Ishte spekuluar se von der Leyen nuk do ta vizitonte Serbinë gjatë turneut ballkanik për shkak të tensioneve politike dhe shoqërore në vend, ndërsa varrimi i Ratko Mlladiqit, i dënuar për krime lufte dhe gjenocid, kishte nxitur reagime të ashpra në Bashkimin Evropian. Edhe disa deputetë të Parlamentit Evropian i kishin bërë thirrje shëfës së Komisionit Evropian që të mos udhëtonte në Beograd.

Në prag të zgjedhjeve parlamentare dhe të përgjithshme në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë, presidentja e Komisionit Evropian planifikon t'i vizitojë këto dy vende më vonë, tha Podesta.

Ky do të jetë turneu i gjashtë i von der Leyen në rajon, një vizitë që tashmë është bërë traditë para publikimit të paketës vjetore të raporteve të progresit për vendet candidate për anëtarësim në BE.

"Siç tha presidentja në samitin e qershorit, Bashkimi ynë nuk do të jetë i plotë pa Ballkanin Perëndimor. Gjatë bisedimeve me partnerët, ajo do të diskutojë për hapat e nevojshëm në rrugën e këtyre vendeve drejt Bashkimit Evropian, si dhe për procesin e integritit gradual, të mbështetur nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor", tha zëdhënësjja Podesta.

18 Shtator 2026, 15:10Rajoni TEMA

[Proteste ne Prishtine, mijera qytetare "pushtojne" sheshin ne mbeshtetje te ish-krereve te UÇK-se \(VIDEO\)](#)

[Protestë në Prishtinë, mijëra qytetarë "pushtojnë" sheshin në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së \(VIDEO\)](#)

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Avokati i Thaçit reagon ndaj deklaratës së Marta Kos: Nuk të takon ta paragjykosësh çështjen ndaj tij](#)

15:00 Rajoni

Protestë në Prishtinë, pro UÇK-së - Djali i Jakup Krasniqit: Të bashkohemi përtej partive e ndasive! Historinë e Çlirimtarëve nuk mund ta fshijë askush

13:30 Rajoni

Dënimi i ish-krerëve të UÇK, protestuesit zbulojnë 4 kërkesat: Shfuqizoni ligjin për Dhomat e Specializuara, të shkarkohet Gërvalla dhe...

13:10 Rajoni

Serbia hap fabrikën e dronëve izraelitë, Vuçiç: Do të furnizojmë edhe ushtri të tjera

12:50 Rajoni / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.